

URDHËR
Nr. 682, datë 21.12.2020

**PËR NDALIMIN E LËVIZJES PËRMES RRUGËVE AJRORE ME BRITANINË E
MADHE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 3, germa “a”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”; në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, si edhe vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri nr. 5612 datë 21.12.2020,

URDHËROJ:

1. Pezullimin e transportit ajror të pasagjerëve me Britaninë e Madhe duke filluar nga ora 06:00, datë 22.12.2020, deri në datën 6.1.2021.
2. Vetëkarantinimin e detyrueshëm, për një periudhë 14-ditore, për të gjithë shtetasit që hyjnë në Republikën e Shqipërisë përmes rrugëve ajrore, tokësore ose detare, dhe kanë nisur udhëtimin e tyre nga Britania e Madhe.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, si dhe organet e tjera sipas aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**